

20151524363

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PËRMENDORE
MEMORIALE DHE SHENJA PËRKUJTIMORE

Neni 1

Në Ligjin për përmendore memoriale dhe shenja përkujtimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/2004 dhe 89/2008), në nenin 28 në paragrafin (1) fjalët: "4.000 deri" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

„(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.”

Në paragrafin (3) fjalët: „800 deri 1.000“ zëvendësohen me fjalët: „500 deri 750“.

Neni 2

Në nenin 29 në paragrafin (1) fjalët: "2.000" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

„(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.”

Në paragrafin (3) fjalët: „800 deri 1.000“ zëvendësohen me fjalët: „300 deri 450“.

Neni 3

Titulli para nenit dhe neni 29-b ndryshohen si vijon:

“Procedurë për dhënien e urdhërpagesës kundërvajtëse

Neni 29-b

(1) Për kundërvajtjet nga nenet 28 dhe 29 nga ky ligj, inspektori për kulturë kryerësit të kundërvajtjes t'i jep urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, të njëjtën duhet ta nënshkruaj. Pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet mënyra në të cilën do të hiqen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e bërë.

(4) Kur si kryerës të kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën kundërvajtëse e nënshkruan personi përgjegjës apo personi i autorizuar nga ai.

(5) Inspektori i kulturës është i detyruar të mbajë evidencë për urdhërpagesat kundërvajtëse dhe për rezultatit nga procedurat e ngritura.

(6) Në evidencën nga paragrafi (5) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i jepet dhe rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën.

(8) Ministri i përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse.”

Neni 4

Pas nenit 29-b shtohet neni i ri 29-v, si vijon:

„Neni 29-v

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.”

Neni 5

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.